

Vendim nr. 177 datë 18.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 18.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (R) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **RENATO ZALLEMI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1659, datë 16.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Renato Zallemi (*kërkuesi*) ka paraqitur kërkesë me objekt përfitimin nga amnistia e pjesshme në gjykatat e zakonshme, duke kërkuar konvertimin e dënimit me burgim të përjetshëm, në dënim me 20 vjet burgim, sipas ligjit nr. 8202 datë 27.03.1997 “Për amnistinë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8202/1997*). Duke qenë se faktet dhe rrethanat e procesit të kundërshtuar nga kërkuesi lidhen me faktet dhe rrethanat e proceseve të tjera gjyqësore, në vijim të këtij vendimi do të pasqyrohen të gjitha proceset gjyqësore që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

(i) Procesi i parë gjyqësor

2. Kërkuesi është dënuar penalisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 35, datë 04.03.1997, përmes së cilit është vendosur deklarimi i tij fajtor për veprat penale “Vrasja për interes” dhe “Armëmbajtja pa leje”, të parashikuara nga nenet 84/a dhe 278/2 të Kodit Penal (KP). Kjo gjykatë e ka dënuar kërkuesin me burgim të përjetshëm për veprën penale të parashikuar nga neni 84/a i KP-së dhe me 3 vjet burg për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së. Në bazë të nenit 57 të KP-së, në bashkim të dënimeve, përfundimisht kërkuesi është dënuar me burgim të përjetshëm. Gjykata ka urdhëruar, gjithashtu, organet kompetente të ekzekutonin vendimin në çdo kohë që të ishte e mundur dhe kudo që të gjendej kërkuesi.

3. Vendimi i mësipërm është dhënë në mungesë të kërkuesit, i cili pasi është arrestuar në datën 01.10.2001 nga policia greke, është ekstraduar në zbatim të kërkesës së shtetit shqiptar për vuajtjen e dënimit penal. Pas këtij momenti, ai ka ushtruar të drejtën e ankimit.

4. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 51, datë 18.04.2002, ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë nga kërkuesi kundër vendimit nr. 35, datë 04.03.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi ky ankim ishte depozituar jashtë afatit ligjor. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 48, datë 22.04.2002, ka vendosur të rivendosë në afat kërkuesin për të paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 35, datë 04.03.1997 të së njëjtës gjykatë.

6. Pas paraqitjes së ankimit, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 110, datë 08.10.2003, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 35, datë 04.03.1997 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi kjo gjykatë ka vlerësuar se vendimi ishte i bazuar në prova dhe në ligj. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 230, datë 07.05.2004, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

(ii) Procesi i dytë gjyqësor

8. Në vitin 2010 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesë për përfitim amnistie të pjesshme, duke pretenduar si shkak ligjor për përfitimin e saj se ai është paraqitur vullnetarisht përpara organeve të drejtësisë greke për të vuajtur dënimin e dhënë me vendimin nr. 35 datë 04.03.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 561 datë 08.10.2010, ka shpallur moskompetencën tokësore për shqyrtimin e çështjes, duke e dërguar atë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1205(13-2011-3731), datë 21.07.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përfitim amnistie, duke argumentuar se i dënuari nuk rezultonte të ishte paraqitur vullnetarisht para organeve proceduese dhe as të ishte larguar nga burgu dhe si pasojë ai nuk përmbushte kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 2 i ligjit nr. 8202/1997 për të përfituar nga zbatimi i tij. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2014-219 (23) datë 23.01.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-805, datë 18.10.2017, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi ndaj vendimit nr. 10-2014-219 (23), datë 23.01.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës, pasi ky rekurs nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

(iii) Procesi i tretë gjyqësor

11. Kërkuesi i është drejtuar sërish në datën 01.07.2020 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me kërkesë me objekt përfitimin nga amnistia e pjesshme, duke ndryshuar shkakun ligjor për kërkimin e saj. Shkakun i pretenduar nga kërkuesi në këtë gjykim ishte ai i mospasjes dijeni për hetimet e kryera nga organi i akuzës dhe për marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës.

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2020-3591 (232), datë 14.12.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij si të pabazuar në ligj, me arsyetimin se në analizë të provave të administruara në gjykim, të pretendimeve të palës kërkuese, por edhe të

dispozitave të aplikueshme për rastin konkret, kërkesa e paraqitur prej të kërkuarit ishte e pabazuar në ligj e për pasojë ajo duhej të rrëzohej. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur ankim, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës.

13. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 46, datë 09.03.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 41-2020-3591 (232), datë 14.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me arsyetimin se shqyrtimi i kërkesave gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit, që përmbajnë të njëjtin objekt dhe fakte, bëhet mbi bazën e parimit të gjyqimit vetëm një herë të kërkesës. Nëse kërkesa është vlerësuar si e pabazuar në ligj e prova, me vendim të formës së prerë, i dënuari nuk mund të paraqesë të njëjtën kërkesë, me objekt e fakte të njëjta me kërkesën e mëparshme, të rrëzuar me vendim të formës së prerë. Gjykata e Apelit Korçë ka vlerësuar, gjithashtu, se nuk provohet kriteri i paraqitjes vullnetare brenda afatit ligjor, në mënyrë që kërkuar të përfitojë nga amnistia sipas nenit 2 të ligjit nr. 8202/1997. Kundër këtij vendimi, kërkuar ka ushtruar rekurs.

14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1659, datë 16.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, kundër vendimit nr. 46, datë 09.03.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, pasi ka vlerësuar se vendimi i kësaj gjykate është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit nr. 8202/1997 dhe asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuar nuk e bëjnë atë të cenueshëm.

15. Kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 12.06.2023 me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e vendimit përfundimtar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

II

Pretendimet e kërkuarit

16. Kërkuar, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

16.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

16.1.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka gabuar në arsyetimin e vendimit gjyqësor, ku shprehet se nuk rezulton se kërkuar të jetë trajtuar ndryshe nga individë apo kërkuar që janë në kushte të barabarta me të. Sipas kërkuarit, ky kolegji ka arsyetuar gjithashtu se pretendimi i tij se gjykata nuk ka zbatuar parimin e barazisë para ligjit është i pabazuar, pasi

përfituesit e tjerë nga kjo amnisti kanë qenë në kushte objektivisht të ndryshme nga ato të kërkuarit, pasi ata janë vetë dorëzuar përpara organeve kompetente. Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar pretendimin e ngritur në rekurs se gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim dhe vlerësim shkakun ligjor të ngritur në kërkesën për përfitimin e amnistisë së pjesshme, si dhe ankimin për përmbajtjen e elementeve antikushtetuese në vendosjen e kriterëve të afatëve për kthimin vullnetar të përfituesve tek organi procedues.

16.2. *Parimi i barazisë para ligjit* i lidhur me *të drejtën për gjykim të drejtë*, të garantuar nga nenet 18, pika 1 dhe 42 të Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar në vendimmarrjen e tij shkaqet e paraqitura në rekurs lidhur me pamundësinë objektive të kërkuarit për të plotësuar kriterin e paraqitjes vullnetare tek organet proceduese brenda datës 30.01.1998, të parashikuar nga ligji nr. 8202/1997, edhe pse ai ka paraqitur në cilësinë e provës vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, përmes së cilit është rivendosur në afat e drejta e tij e ankimit ndaj vendimit nr. 35, datë 04.03.1997 të po kësaj gjykate, ku vërtetohet se ai nuk ka pasur dijeni mbi procesin penal të zhvilluar ndaj tij. Ky kolegji, ndonëse e pranon se përfituesit e tjerë nuk kanë qenë në kushtet e kërkuarit, pasi ata i kanë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për të përfituar amnistinë, nuk ka vlerësuar se kërkuari ka qenë në kushte objektivisht të ndryshme nga ta. Gjykata e Lartë duhet t'i jepte zgjidhje tjetër kësaj çështjeje, duke vlerësuar rrethanat objektive penguese të paraqitura nga kërkuari dhe të faktuara me vendim gjyqësor, lidhur me mosparaqitjen e tij vullnetare përpara organeve kompetente.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të

drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

18. Kolegji vlerëson se kërkuuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

19. Një kriter tjetër paraprak, që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tij për përfitim të amnistisë së pjesshme. Në këtë situatë vlerësohet se ai nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara dhe, për rrjedhojë, ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

21. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 16.12.2022, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur, fillimisht, në Gjykatë në datën

02.06.2023 dhe pas plotësimit të tij, është regjistruar në datën 12.06.2023. Kërkuesi ka pretenduar se është vënë në dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë në datën 25.05.2023, që përkon me datën e tërheqjes së këtij vendimi në sportelin e sekretarisë gjyqësore, fakt që rezulton i shënuar në faqen e fundit të këtij vendimi. Sipas informacionit të administruar për efekt të shqyrtimit të këtij ankimi, përmes shkresës nr. 3669/1 prot., datë 04.07.2023 të Gjykatës së Lartë, vendimi i kësaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët në datën 24.01.2023 dhe është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 06.02.2023.

22. Në rastin konkret, Kolegji vëren se data e arsyetimit dhe publikimit të vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është 06.02.2023, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur në Gjykatë në datën 02.06.2023. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

23. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

24. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se, ndër të tjera, kërkuesi ka pretenduar se vendimi gjyqësor i kundërshtuar i ka cenuar parimin e barazisë para ligjit të lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, të garantuar nga nenet 18, pika 1 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe neni 14 i KEDNJ-së, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar në vendimmarrjen e tij shkaqet e paraqitura në rekurs lidhur me pamundësinë objektive të kërkuesit për të plotësuar kriterin e paraqitjes vullnetare tek organet proceduese brenda datës 30.01.1998, të parashikuar nga ligji nr. 8202/1997, edhe pse ai ka paraqitur në cilësinë e provës vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, përmes së cilit është rivendosur në afat e drejta e tij e ankimit ndaj vendimit nr. 35, datë 04.03.1997 të po kësaj gjykate, ku vërtetohet se ai nuk ka pasur dijeni mbi procesin penal të zhvilluar ndaj tij. Ky kolegji, ndonëse e pranon se përfituesit e tjerë nuk kanë qenë në kushtet e kërkuesit, pasi ata i kanë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për të përfituar amnistinë, nuk ka vlerësuar se kërkuesi ka qenë në kushte objektivisht të ndryshme nga ta. Gjykata e Lartë duhet t’i jepte zgjidhje tjetër kësaj çështjeje, duke vlerësuar rrethanat objektive penguese të paraqitura nga kërkuesi dhe të faktuara me vendim gjyqësor, lidhur me mosparaqitjen e tij vullnetare përpara organeve kompetente.

25. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues, pasi nuk ka arritur të argumentojë se ai është trajtuar në mënyrë të ndryshme në krahasim me subjekte të tjera, që ndodhen në kushte objektivisht të njëjta me të. Kolegji vëren, gjithashtu, se në interpretim të nenit 18 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të tij për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, që, në thelb, ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nr. 8202/1997 nga gjykatat në raste të njëjta (*shih vendimin nr. 00-2022-1659, datë 16.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 10, paragrafët 19, 19.1 dhe 19.2*).

26. Për më tepër, Kolegji çmon se, ashtu siç u theksua më lart, ky pretendim i kërkuessit lidhet me interpretimin gjyqësor të ligjit nga gjykatat dhe si i tillë edhe me cenimin e parimit të sigurisë juridike për sa i përket parashikueshmërisë së zbatimit të ligjit nga gjykatat, i cili gjithashtu nuk është ngritur në nivel kushtetues. Si rrjedhim, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Për sa i takon pretendimit që lidhet me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, Kolegji vlerëson se ky pretendim *prima facie* përfshihet në kompetencën e Gjykatës, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuuesi ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka gabuar në arsyetimin e vendimit gjyqësor, ku shprehet se nuk rezulton që kërkuuesi të jetë trajtuar ndryshe nga individë apo kërkuess që janë në kushte të barabarta me të. Sipas kërkuessit, ky kolegji ka arsyetuar gjithashtu se pretendimi i tij se gjykata nuk ka zbatuar parimin e barazisë para ligjit është i pabazuar, pasi përfituesit e tjerë nga kjo amnisti kanë qenë në kushte objektivisht të ndryshme nga ato të kërkuessit, pasi ata janë vetë dorëzuar përpara organeve kompetente. Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar pretendimin e ngritur në rekurs se gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim dhe vlerësim shkakun ligjor të ngritur në kërkesën për përfitim të amnistisë së pjesshme, si dhe ankimin për përmbajtjen e elementeve antikushtetuese në vendosjen e kriterëve të afateve për kthimin vullnetar të përfituesve tek organi procedues.

29. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vëren se Gjykata ka pohuar se amnistia përbën një masë të përgjithshme faljeje për kategori të përcaktuara veprash penale të kryera në një periudhë të caktuar kohe, ose dënimeve përkatëse. Amnistia e veprës penale vepron përpara dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit, me pasojë shuarjen e veprës penale të kryer, ndërsa amnistia e dënimit ndërhyr pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar ekzekutimin e dënimit dhe të dënimeve plotësuese, edhe pse mbeten efektet e tjera penale. Ndryshimi midis tyre qëndron në faktin se amnistia e veprës penale sjell si pasojë mosfillimin ose pushimin e ndjekjes penale përpara se të jetë dhënë një vendim përfundimtar dënimi (i ekzekutueshëm), ndërsa amnistia e dënimit sjell efekte pas dhënies së vendimit të ekzekutueshëm *(shih vendimet nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 16, datë 19.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës *(shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Sipas Gjykatës, nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e këtyre gjykatave. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Gjykata rithekson se detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë *(shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë gjykuar kërkesën e kërkuarit, të paraqitur në vitin 2010, për përfitimin e amnistisë së pjesshme, duke vendosur rrëzimin e saj. Në datën 01.07.2020 kërkuari ka paraqitur sërish kërkesë me të

njëjtin objekt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar në ligj. Gjatë shqyrtimit të çështjes, kjo gjykatë ka mbajtur parasysh faktin se nga ana formale, shkak i pretenduar nga kërkuesi ishte i ndryshëm nga ai i pretenduar më herët prej tij, pasi në gjykimin e mëparshëm ai kishte pretenduar si shkak se ishte paraqitur vullnetarisht përpara organeve të drejtësisë greke për të vuajtur dënimin, ndërsa në kërkesën objekt shqyrtimi shkak i pretenduar është ai i mospasjes dijeni për hetimet e kryera nga organi i akuzës ose dhe për marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës. Më tej, gjykata ka analizuar kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8202/1997, duke dalë në përfundimin se kërkuesi nuk provonte plotësimin e kriterit ligjor, që lidhej me paraqitjen e tij vullnetare përpara organit procedues ose me kthimin vullnetarisht në burg brenda datës 30.01.1998, për të cilin ai ka paraqitur si shkak mospasjen dijeni mbi hetimin e zhvilluar nga organi i akuzës apo gjykimin dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ajo ka theksuar se vetëm ky argument i përdorur prej tij është i pamjaftueshëm për të dalë në përfundimin se nëse kërkuesi po të ishte në dijeni të hetimit, të gjykit të tij ose edhe të vendimmarrjes së gjykatës përkatëse, do të paraqitej vullnetarisht para organit procedues. Kjo gjykatë ka argumentuar gjithashtu se nga kërkuesi bëhet keqinterpretim lidhur me plotësimin e kriterit të mësipërm, pasi në thelb, ligjvënësi duke përdorur termin “kthehen vullnetarisht në burg” nënkupton rastin e kthimit të të dënuarve me vendim të formës së prerë, që ishin larguar më herët nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe jo në rastin e kërkuesit, kur ndaj tij ende nuk kishte filluar ekzekutimi i vendimit penal për dënimin e dhënë me burgim të përjetshëm (*shih vendimin nr. 41-2020-3591 (232), datë 14.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, faqet 5-8*).

33. Ky vendim është ankimuar nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjykata e apelit ka arsyetuar se kërkesa në shqyrtim ishte e njëjtë me kërkesën e rrëzuar më parë me vendim të formës së prerë. Në këto rrethana, kjo gjykatë ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për përfitimin nga amnistia ishin shqyrtuar një herë, vendimi i formës së prerë ishte i detyrueshëm në këtë gjykim dhe gjykata nuk mund të dispononte ndryshe për të njëjtën kërkesë të rrëzuar me vendimin e formës së prerë. Po kështu, gjykata e apelit e ka vlerësuar të bazuar arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me kriterin e paraqitjes vullnetare pranë organit procedues, në mënyrë që të përfitohej amnistia e dënimit, duke arsyetuar se e drejta për të përfituar nga amnistia është e kufizuar me afatin ligjor. Sipas nenit 2 të ligjit nr. 8202/1997 kanë

përfituar vetëm ata të dënuar që janë paraqitur vullnetarisht brenda afatit të caktuar e jo të tjerët. *(shih vendimin nr. 46, datë 09.03.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, faqja 4, paragrafi 5, faqja 6, paragrafët 9 dhe 10).*

34. Kërkuesi ka ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin. Ky kolegji ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së apelit ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit nr. 8202/1997, si dhe e ka vlerësuar të drejtë arsyetimin e gjykatave të faktit se kërkuesi nuk plotësonte kriterin ligjor lidhur me vetëdorëzimin e tij vullnetarisht në institucionin e vuajtjes së dënimit në datën e parashikuar në ligj. Ky kolegji e ka konsideruar të pamjaftueshëm argumentin e kërkuesit se nuk ka pasur dijeni për procedimin penal në ngarkim të tij, për gjykimin dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe ka vlerësuar se nuk mund të pranojë kërkesën e kërkuesit, duke arsyetuar me hamendësime, se nëse ai do të kishte dijeni për vendimin e formës së prerë atëherë do të ishte vetëdorëzuar, për sa kohë që ligjvënësi në formulimin e ligjit nr.8268/1997 ka përcaktuar qartë se përfitojnë nga amnistia personat, të cilët deri në datën 30.01.1998 paraqiteshin vullnetarisht përpara organit procedues apo ktheheshin vullnetarisht në burg. Ndërkohë që, nga aktet e administruara, vendimi i dënimit të tij është ekzekutuar vetëm disa vite më vonë pas këtij momenti. Ky Kolegji ka arsyetuar gjithashtu se parashikimi i nenit 2/a të ligjit të sipërcituar lidhet me faktin se nga amnistia përfitojnë edhe personat të cilët janë larguar nga burgu dhe arrestohen pas datës 12.04.1997 dhe termi “kthyer” nënkuptonte rastin e kthimit të të dënuarve me vendim të formës së prerë, që ishin larguar më herët nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale *(shih vendimin nr. 00-2022-1659, datë 16.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 8, paragrafi 14, faqja 9, paragrafi 15, faqet 9-10, paragrafi 19).*

35. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar, gjithashtu, se barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme, por presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Ky kolegji ka theksuar se kërkuesi nuk ishte trajtuar ndryshe nga individë ose kërkues që ishin në kushte të barabarta me të dhe se pretendimi i tij se gjykata nuk ka zbatuar parimin e barazisë para ligjit, sikurse me përfituesit e tjerë, ishte i pabazuar. Ky arsyetim mbështetet në faktin se përfituesit e tjerë kanë qenë në kushte objektivisht të ndryshme nga ato të kërkuesit, pasi ata ishin vetëdorëzuar përpara organeve kompetente. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se kërkesa e kërkuesit, me objekt konvertimin e dënimit nga burgim të përjetshëm në 20 vjet

dënim, është gjykuar edhe më parë nga gjykatat, ku është rrëzuar me vendim të formës së prerë *res judicata*, si dhe ka theksuar se shkaku i pretenduar është kontradiktor në lidhje me shkaku e paraqitur në kërkesën e parë, ku është pretenduar se ai është vetëdorëzuar përpara shtetit grek në lidhje me ekzekutimin e vendimit nr. 35, datë 04.03.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (*shih vendimin nr. 00-2022-1659, datë 16.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 10, paragrafët 19.2 dhe 20*).

36. Për sa më lart, Kolegji konstaton se gjykatat kanë rrëzuar kërkesën e kërkuarit për të përfutur nga amnistia e pjesshme, pasi ai nuk plotësonte kriterin ligjor që ka të bëjë me paraqitjen vullnetare para organit procedues ose kthimin vullnetarisht në burg brenda datës 30.01.1998, si dhe kërkesa e tij e mëparshme me të njëjtin objekt është rrëzuar nga gjykatat me vendim të formës së prerë *res judicata*.

37. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Sipas Gjykatës, ajo ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore, raste në të cilat Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata, duke ndjekur edhe qasjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrar ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte

bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vëren se, në thelb, pretendimi i kërkuarit lidhet me interpretimin e dispozitave të ligjit nr. 8202/1997 për sa u përket kritereve ligjore që duhen përmbushur nga të dënuarit për të përfituar nga amnistia.

40. Nën dritën e standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave, Kolegji vëren se interpretimi që gjykatat u kanë bërë dispozitave ligjore nuk rezulton të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë dhënë përgjigje të argumentuara në lidhje me to, në respektim të standardit të arsytimit të vendimit.

41. Për më tepër, Kolegji vëren se në tërësinë e tij vendimi objekt shqyrtimi paraqitet i rregullt në formë dhe nuk rezulton të ketë paqartësi, duke u dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të ngritura në rekurs. Pjesa hyrëse, ajo arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Lartë vlerësohen në harmoni me njëra-tjetrën, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

42. Në kushtet kur Kolegji vlerëson se ky kriter paraprak nuk plotësohet dhe pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

43. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.